



Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut në kuadër të projektit IPA "Aktivizimi i grupeve të cënueshme në tregun e punës" i financuar nga Bashkimi Evropian, dhe bazuar në Planin Operativ për programe aktive dhe masa për punësimin dhe shërbimet e tregut të punës për vitin 2020, i miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, për masën 3.3 **Trajnime për profesionet e kërkuara**, më datën 08.10.2020, shpall

SHPALLJE PUBLIKE

për

**personat e regjistruar të papunë të cilët janë
përfitues të ndihmës minimale të garantuar**

Ftohen personat e regjistruar të papunë, përfitues të ndihmës minimale të garantuar, të cilët janë të interesuar të marrin pjesë në trajnime për profesionet e kërkuara në tregun e punës, të regjistrohen në klubet e punës, të qendrave të punësimit ku janë të evidentuar, si persona të papunë jo më vonë se **22.10.2020**. Trajnimet do të kryhen nga realizues të verifikuar të trajnimeve dhe u referohen profesioneve dhe qyteteve vijuese:

1. **Automekanik**- Manastir, Tetovë, Shkup, me minimum arsim fillor të përfunduar
2. **Asistent për kujdesin e personave me demencion- sëmundje Alchajmer dhe aftësi të kufizuara intelektuale** - Shkup, me minimum arsim fillor minimal të përfunduar
3. **Bravandreqës** - Negotinë, me minimum arsimin e mesëm të përfunduar
4. **Kuzhinier** - Tetovë, Veles, me minimum arsimin fillor të përfunduar
5. **Përpunues mobilesh** - Tetovë, me minimum arsimin fillor të përfunduar
6. **Kozmetist** - Strumicë, Shkup, me minimum arsim fillor të përfunduar
7. **Asistent personal i personave me aftësi të kufizuara** - Shkup, me minimum arsim të mesëm të përfunduar
8. **Manikyr/Pedikyr**- Strumicë, Shkup, me minimum arsim fillor të përfunduar
9. **Instalues për ngrohje, ftohje dhe klimatizim** - Shkup, me minimum tre vjet të arsimit të mesëm profesional të përfunduar





10. **Përkujdesës i personave te moshuar dhe te pafuqishëm** - Makedonska Kamenicë, Berovë, Kumanovë, Manastir, Tetovë, me minimum arsimin fillor të përfunduar
11. **Pasticier** - Tetovë, Gostivar, Manastir, me minimum arsimin fillor të përfunduar
12. **Pirunier**- Manastir, me minimum arsimin fillor të përfunduar
13. **Operator i makinerive të ndërtimit** - Negotinë, Tetovë, me minimum arsimin e mesëm të përfunduar
14. **Nëpunës për kontabilitet** - Shkup, Kumanovë, Shtip, Kavadarci, Manastir, me minimum arsim të mesëm të përfunduar
15. **Floktar** - Shkup, Kumanovë, Tetovë, Gostivar, me minimum arsim fillor të përfunduar
16. **Rrobaqepës**- Tetovë, me minimum arsimin fillor të përfunduar

Trajnimi do të realizohet në një periudhë prej 2 muajsh, dhe pas përfundimit të trajnimit kandidatët do të kryejnë punë praktike ditore në kushte reale, me punëdhënësit për një periudhë prej 1 muaj. Nëse si realizues i trajnimit janë kompani private (punëdhënës), puna praktike për një periudhë prej 1 muaj mund të kryhet te e njëjta kompani private (punëdhënës).

Personat e përfshirë në trajnim do të marrin kompensim mujor prej 9,000.00 denarë, përfshirë sigurimin për invaliditet dhe dëmtim trupor të shkaktuar nga dëmtimi në punë, ose sëmundja profesionale dhe tatimin mbi të ardhurat personale, për kohëzgjatjen e trajnimit.

Personat e papunë, që do të përfundojnë trajnimin, punën praktike dhe do të kalojnë me sukses provimin e parashikuar, do të marrin një Certifikatë të lëshuar nga realizues të verifikuar të trajnimit.

Pas përfundimit të trajnimit, realizuesit e trajnimit kanë mundësinë të sigurojnë 30-50% punësim, për kandidatët që kanë përfunduar me sukses trajnimin dhe kanë marrë një Certifikatë. Periudha minimale për punësimin e një numri të caktuar personash të trajnuar është tre muaj rresht, nga një periudhë pas përfundimit të trajnimit me kohë të plotë pune.

Personat e evidentuar të papunë, që janë përfitues të kompensimit financiar, ose përdorin të drejtën për ndihmë financiare nga mbrojtja sociale, gjatë trajnimit nuk e humbin këtë të drejtë.



Kushtet, të drejtat dhe detyrimet do të rregullohen me lidhjen e një marrëveshje ndërmjet Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe kandidatëve të selektuar.

Trajnimet do të kryhen nëse ka një numër të mjaftueshëm të kandidatëve të paraqitur.

Personat që janë përfshirë më parë në këtë masë nuk mund të marrin pjesë në trajnime.

Informacione të hollësishme mund të merren në klubet e punës të 30 Qendrave të Punësimit, në ueb faqen e Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut www.av.gov.mk, në ueb faqen e APRMV www.av.gov.mk, si dhe në FB faqen e Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Për të gjitha pyetjet shtesë mund të kontaktoni zyrën e IPA-s, për projektin në e-mail: ipa@av.gov.mk; ipa4esarnm@gmail.com dhe info@av.gov.mk.

